

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

**VENDIM
Nr. 36, datë 31.03.2026**

PËR

**MIRATIMIN E PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE TË
SHOQËRISË SË SIGURIMIT “SiCRED” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 89, pika 9, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Drejtorisë të Administrimit të Riskut dhe Modeleve Financiare, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e mjaftueshmërisë së provigjoneve teknike dhe matematike të shoqërisë “SiCRED” SH.A., siç paraqiten në 31 dhjetor 2025, sipas përlllogaritjes së shoqërisë.**
- 2. Miratimin e përfshirjes në pasqyrat financiare të shoqërisë për mbylljen e vitit financiar 2025 të provigjoneve teknike dhe matematike totale të konvertuara në lekë si më poshtë:**

Provigjonet teknike dhe matematike në 31 dhjetor 2025	Lekë
Provigjone teknike të primeve e dëmeve bruto në total	347,877,265
<i>Provigjone teknike të primeve e dëmeve në total – pjesa e risiguruesve</i>	<i>20,684,776</i>
Provigjone teknike të primeve e dëmeve neto në total	327,192,489

- 3. Ngarkohet shoqëria për zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Adela XHEMALI